

por ai ose ajo mund të rrimërohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në zbatim të këtij ligji.

Ju nuk jeni thirrur në cilësinë e përfaqësuesit të Bankës së Shqipërisë. Ju jeni thirrur në cilësinë e Inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë, që propozohet, zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi.

Ju jeni thirrur për të raportuar mbi përmbushjen e detyrave specifike që ligji përcakton për ju në nenin 54, pika 3, gërmat a, b, c, të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”.

Refuzimi juaj është antiligjor, në thyerje të rëndë të etikës dhe pa precedentë të tjerë në 23 vite.

Refuzimi juaj është refuzimi i autoritetit Kushtetues të institucionit më të lartë të Republikës, Kuvendit të Shqipërisë.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, i Kuvendit, ju fton edhe një herë nesër, në orën 11:30, të paraqiteni para këtij Komisioni për të dhënë dëshminë tuaj lidhur me përmbushjen e detyrës në krye të Departamentit të Kontrollit të Bankës së Shqipërisë.

Në të kundërt, Komisioni ju kujton se jemi në kushtet e nenit 54, pika 2, që refëron në nenin 47, pika 2 gërma c, e ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”:

*Neni 47*

2. Guvernatori dhe zëvendësguvernatorët e Bankës së Shqipërisë, si dhe çdo anëtar tjetër i Këshillit Mbikëqyrës, mund të shkarkohen nga Kuvendi me propozim të shumicës së gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, kur:

c) personi i propozuar për shkarkim gjatë ushtrimit të detyrës ka shkelur rëndë etikën e punës dhe ka cenuar thellë interesat e Bankës së Shqipërisë.

Erion Braçe

Kryetar

